



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr.

Prot.

Tiranë ____/____/2020

Lënda: Rekomandime për marrjen e masave të nevojshme nga strukturat kompetente për identifikimin, administrimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare. (Rekomandime të dala nga hetimi administrativ i rastit të vrasjes së shtetases E. Ç.)

DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË SHTETIT

Drejtues Madhor Ardi Veliu

Tiranë

PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Z. Olsian Çela

Tiranë

INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Z. Artur Metani

Tiranë

KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Tiranë

BASHKISË

Kamëz

Të nderuar,

Avokati i Popullit ka regjistruar me nismën e vet konform dispozitave të ligjit, nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, rastin e bërë publik në median e shkruar dhe atë elektronike lidhur me vrasjen e shtetases E.Ç.me banim në Paskuqan nga kunati i saj Erdet Çapoku, në prezencën e së ëmës dhe vajzës së saj 18 vjeçe.

Në kuadër të hetimit administrativ u krijua një grup hetimor multidisiplinar, i përbërë nga dy ndihmëskomisionerë, një punonjës social dhe një jurist, të cilët në vlerësimin dhe analizimin e provave dhe fakteve të administruara mbi ngjarjen e ndodhur, u drejtuan nga parimet kryesore të paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizimit dhe pavarësisë.

Metodologjia e hetimit administrativ është bazuar në:

Së pari, kërkimin nga të gjitha institucionet përgjegjëse të informacionit mbi trajtimin e rastit të shtetas E.Ç.dhe konkretisht:

- Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje (MKR), Bashkia Kamëz;
- Komisariatit të Policisë nr.5 Tiranë;
- Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë;
- Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Së dyti, vlerësimin dhe analizimin e saktë të informacionit, provave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucionet respektive të përmendura më lart, për të konstatuar dhe analizuar veprimet ose mosveprimet e ndërmarra nga ana e tyre.

Së treti, vlerësimin e hollësishëm të të gjitha provave së bashku, për të marrë rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

Vlerësimi i rastit nëpërmjet përfaqësuesve të Komisariatit të Policisë Nr.5 Tiranë

Nga dokumentacioni i dërguar nga Komisariati i Policisë nr.5 Tiranë me shkresën nr. 212/1 prot., datë 24.01.2020, rezultoi se:

Në datën 18.09.2019, shtetasja E.Ç.ka bërë një kallëzim penal ndaj kunatit të saj, E.Ç.në të cilin ka deklaruar se shtetasi E.Ç.në datën 11.09.2019 e kishte fotografuar atë në një bar kafe ku ajo ishte e shoqëruar me vajzën e saj dhe një të afërmin e vet si dhe e ka përndjekur.

Fotot e printuara, 19 copë, shtetasi E.Ç.ia ka dërguar bashkëshortit të shtetas Enkeleda Çapoku, i cili vuan dënimin në IEVP Fier.

Në datën 13.09.2019, kur shtetasja E.Ç.ka shkuar për vizitën e radhës tek bashkëshorti në IEVP Fier, ky i fundit i ka treguar asaj fotografitë që i kishte nisur i vëllai i tij, Erdet Çapoku, situatë për të cilën ata të dy kanë debatuar.

Ndërsa në datën 18.09.2019, rreth orës 06:30, sapo E.Ç.ka dalë nga banesa e saj, i ka dalë përpara kunati shtetasi E.Ç.i cili e ka kërcënuar duke i thënë: “Do të fus plumbin në kokë!” dhe është larguar me biçikletë.

Në kushtet kur ajo është ndjerë e kërcënuar familjarisht (bashkë me të bijën 18 vjeçe), ka shkuar në Komisariatit të Policisë nr.5 ku ka bërë kallëzim penal dhe ka kërkuar që ky problem të ndiqej nga organet kompetente.

Nga Oficerja e Policisë Gjyqësore e Komisariatit të Policisë nr.5 Violeta Progni, në datën 18.09.2019 janë kryer disa veprime procedurale, si më poshtë vijon:

- Është mbajtur procesverbali “Për kallëzimin e veprës penale” të bërë nga shtetasja E.Ç.në bazë të nenit 283 të Kodit të Procedurës Penale, ku ajo ka kallëzuar kunatin E.Ç.për përndjekje, bërje fotografish dhe kanosje.

- Është mbajtur procesverbali “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”, marrë shtetas E.Ç.në bazë të nenit 283 të Kodit të Procedurës Penale.

- Është mbajtur procesverbali “Për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve”, 19 fotografi të dorëzuara nga kallëzuesja.

- Në datën 19.09.2019 është mbajtur procesverbali “Mbi deklarime nga persona ndaj të cilit zhvillohen hetime”, marrë shtetasit Erdet Çapoku, në bazë të nenit 303/2, pika “b” të Kodit të Procedurës Penale. Nga deklarimet e këtij shtetasi rezulton se ai nuk e ka pranuar që të ketë përndjekur, fotografuar dhe kërcënuar kunatën e tij, shtetasen Enkeleda Çapoku.

Në datën 20.09.2019 nga Oficeri i Policisë Gjyqësore Rrezart Bala është përgatitur informacioni “Për referimin e veprës penale te prokurori” në zbatim të nenit 293 të Kodit të Procedurës Penale për veprën penale “Kanosje”, të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Erdet Çapoku.

Me shkresën nr. 6629/k prot., datë 23.09.2019, Komisariati i Policisë nr. 5 Tiranë i ka dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë materialet procedurale për veprën penale “Kanosje”, të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal.

Gjetje

Gjatë hetimit administrativ të këtij rasti u konstatua se:

1. Nga strukturat e Policisë së Shtetit janë zbatuar vetëm pjesërisht detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi. Ndonëse veprimet procedurale lidhur me këtë rast janë kryer menjëherë dhe gjatë orëve të vona të natës, kallëzimi i shtetas E.Ç.është trajtuar si vepër penale “Kanosje”, e parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

2. Në asnjë rast OPGJ-të dhe eprorët e tyre nuk i janë referuar ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, dhe nuk është mbajtur parasysh se kërcënimi shtetas në fjalë i ka ardhur nga kunati i saj, fakt të cilin e ka deklaruar në kallëzimin e bërë.

3. Rasti nuk është referuar tek struktura përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje në këtë komisiariat, e cila është e trajnuar për identifikimin, administrimin dhe ndjekjen e problematikave të tilla.

4. Kallëzueses (viktimë e dhunës në familje) nuk i janë bërë të njohura masat paraprake që mund të merreshin në zbatim të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar si dhe institucionet ku mund të drejtohej për ndihmë. Po ashtu, sipas parashikimeve të këtij ligji, nuk i është bërë e ditur e drejta e saj për t’u pajisur me urdhër mbrojtjeje nga organet kompetente. Respektivisht, "Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme" është urdhri i arsyetuar dhe i lëshuar nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit, që përmban masat e menjëhershme për ndalimin e dhunës, deri në marrjen e vendimit nga gjykata ndërsa "Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje", është urdhri i cili lëshohet përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate, si dhe urdhri i mbrojtjes.

5. Për rrjedhojë nuk është bërë vlerësimi i riskut, nuk është lëshuar “Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme” (UPMM), nuk është hartuar kërkesa për

lëshimin e "Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje", (UMM) apo dhe "Urdhër mbrojtjeje" (UM) për viktimën, mbi bazën e të cilit merren masat paraprake të mbrojtjes së viktimës dhe për ndalimin e dhunës, në bazë të nenit 10, pika 1, gërma "a", "ç", "d", si dhe të nenit 13/1, të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar.

Këto masa konsistojnë në:

a- urdhërimin e dhunuesit/es që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprime të mëtejshme të dhunës në familje ndaj viktimës ose pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës;

b- urdhërimin e dhunuesit/es që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë ose të komunikojë drejtpërdrejtë ose tërthorazi me viktimën ose pjesëtarë të familjes së viktimës;

c- ndalimin menjëherë të dhunuesit/es, që t'i afrohet strehës, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës ose të banesës së personave të tjerë dhe institucioneve arsimore, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktima, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

Hartimi i urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme është i rëndësishëm edhe për vënien në dijeni të koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare pranë Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje (MKR), të Bashkisë Kamëz.

Pavarësisht përmirësimit të kuadrit ligjor dhe punës deri më tani të strukturave përgjegjëse, konstatohet se mbetet një domosdoshmëri trajnimi në vijim dhe me prioritet i të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit, për referimin e rasteve pranë strukturave të posaçme që trajtojnë çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare, kryesisht për identifikimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, për vlerësimin e riskut, për të rritur kapacitetet, bashkërendimin me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje (MKR) e bashkive, si dhe njëkohësisht për t'ju përgjigjur në kohë reale detyrimeve ligjore në parandalimin e dhunës dhe sigurimin e jetës së viktimave.

Vlerësimi i rastit nëpërmjet Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje (MKR), Bashkia Kamëz

Nga dokumentacioni i administruar u informuam se rasti i shtetases E.Ç.nuk njihej më parë nga koordinatorja vendore për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare në Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje (MKR), Kamëz, deri sa u bë i njohur nga media.

Duke mos patur asnjë njoftim mbi rastin në fjalë nga autoritetet përgjegjëse sipas ligjit nr.9669, dt.18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, koordinatorja vendore kundër dhunës nuk e ka trajtuar asnjëherë këtë rast në takimet e ekipit teknik ndërdisiplinor si dhe nuk e ka raportuar në takimin e Komitetit Drejtues "Për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje".

Pas njohjes nëpërmjet medias të rastit të dhunës në muajin janar 2020, koordinatorja vendore për rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare, në bashkëpunim me administratorin shoqëror si dhe në prezencë të përfaqësuesve të Komisarariatit të Policisë nr.5, kanë realizuar vizitën në familje, ku kanë shprehur gatishmërinë për t'i ofruar ndihmë vajzës të së ndjerës.

Gjetje

Duke analizuar dokumentacionin si dhe veprimet e kryera nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje (më poshtë MKR) Kamëz, konstatojmë se:

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje (MKR), Kamëz, duke mos pasur dijeni që në rastin e parë të dhunës, nuk e ka patur subjekt të diskutimit dhe të menaxhimit këtë rast, kështu që nuk ka mundur të përcaktojë qartë detyrat për secilin nga anëtarët e institucioneve përgjegjëse dhe të garantonte mbrojtjen e viktimës dhe të vajzës së saj nga dhuna.

Që në muajin shtator kur rasti është paraqitur pranë Komisarariatit të Policisë nr.5 nuk është kryer vlerësimi i riskut nga organi i Policisë.

Nuk është zbatuar Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”, pjesa II “Detyrat e Policisë së Shtetit për vlerësimin e riskut”, sipas të cilës struktura përgjegjëse pranë Policisë së Shtetit, menjëherë pas identifikimit ose raportimit të rastit të dhunës në familje, ku është identifikuar ose raportuar rasti, merr të gjitha masat për të ndaluar dhunën dhe për të kryer vlerësimin e riskut dhe lëshimin e Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme.

Si përfundim për rastin e kallëzuar në muajin shtator 2019, nuk është kryer vlerësimi i riskut dhe nuk janë marrë masat për mbrojtjen e menjëhershme të shtetasës Enkeleda Çapoku, viktimë e dhunës në familje.

Vlerësojmë se, Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje (MKR) Kamëz, në kuptim të legjislacionit kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, duhet të kishte një koordinim më të mirë midis institucioneve përgjegjëse për të parandaluar dhunën dhe sidomos ripërsëritjen e saj me pasojë humbjen e jetës së shtetasës Enkeleda Çapoku.

Vlerësimi i rastit nëpërmjet veprimeve të kryera nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë

Në veprimet e saj, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mbi bazën e materialit të referuar nga Komisarati i Policisë nr. 5 Tiranë, ka regjistruar dosjen penale për kallëzimin nr.13658, datë 25.9.2019, të bërë nga shtetasja E.Ç.ndaj shtetasit Erdet Çapoku, për veprën penale “Kanosja”, e parashikuar nga neni 84 i “Kodit Penal të RSH-së”.

Në datë 2.10.2019 nga prokurori i çështjes është marrë vendimi për mosfillim të procedimit penal.

Në këtë vendim arsyetohet se:

“Nisur nga analiza e provave si dhe nga praktika gjyqësore, rezulton se nuk ndodhemi para elementëve të veprës penale të “Kanosjes”, parashikuar nga neni 84 i K.Penal, pasi mungojnë elementët e kësaj veprë penale. Kështu që të ndodhemi para kësaj veprë penale duhet që kanosja të jetë serioze, e çastit, që do realizohet në atë moment si dhe të shoqërohet me veprime konkrete, kurse vetëm përdorimi i kërcënimeve me fjalë, nuk le ndonjë dyshim se kanosja do realizohet. Pra ekziston një fakt i cili nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.”

Për këtë arsye, në bazë të gërmës “ç”, të nenit 290 të “Kodit të Procedurës Penale”, ka vendosur mosfillimin e materialit kallëzues nr. 13658, datë 25.09.2019 për veprën penale të “Kanosjes”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal.

Për ironi të arsytimit të prokurorit të çështjes ndonëse sipas të cilit kanosja nuk paska qenë serioze, e çastit, nuk është shoqëruar me veprime konkrete dhe se nuk ka lënë dyshime se kanosja do të realizohej, në fakt rezultoi se, vrasja e të ndjerës ndodhi dhe jeta e saj u mor padrejtësisht dhe në mënyrë mizore nga kanosësi i saj.

Gjetje

Nga përmbajtja e vendimit të mosfillimit të procedimit penal konstatohet se, nga organi i Prokurorisë nuk është kryer asnjë veprim hetimor në lidhje me materialin kallëzues nr. 13658, datë 25.9.2019 të referuar nga Komisariati i Policisë nr. 5 Tiranë, për verifikimin e deklarimeve të kallëzueses se ajo është përndjekur, fotografuar dhe kërcënuar nga kunati i saj, për shkak të marrëdhënieve familjare, si pyetja e vajzës së saj, e bashkëshortit, familjarëve të tjerë, etj. Ndërkohë nga ky organ nuk është bërë vlerësimi me profesionalizëm dhe objektivitet i kallëzimit të të ndjerës dhe kualifikimi i veprës penale të kallëzuar prej saj nga “Kanosje” në “Dhuna në familje”, e parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal dhe në përputhje me ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, i ndryshuar.

Ky qëndrim është në kundërshtim me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet:

1. Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.
2. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik.
3. Ushtrimi i ndjekjes penale është i detyrueshëm, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.
4. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, prokurorët kryejnë veprime, parashitrojnë kërkesa dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

Vlerësimi i rastit nëpërmjet veprimeve të kryera nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Nga informacioni i ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk rezulton të jetë regjistruar çështje civile me objekt lëshimin e urdhërit të mbrojtjes midis palëve E.Ç.dhe Erdet Çapoku.

Ne vlerësojmë se, pavarësisht përmirësimit të vazhdueshëm të legjislacionit shqiptar sipas standarteve të konventave ndërkombëtare kundër dhunës si Konventa “Mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave” (CEDAW) dhe Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), përmirësimit të ligjit nr.9669, dt 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, miratimit të akteve nënligjore në përafrim me legjislacionin e Bashkimit Evropian, në kuadër të parandalimit dhe reduktimit të dhunës në familje në të gjitha format e saj, hartimin e politikave dhe strategjive shtetërore në këtë drejtim, vitet e fundit rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare janë shtuar ndjeshëm në shoqërinë tonë.

Ndërkohë fatkeqësisht janë të frikshme edhe rastet e marrjes së jetëve të grave nga bashkëshortët apo subjektet e tjera të kësaj vepre penale. Ndonëse legjislacioni ynë penal ka pësuar ndryshime me qëllim për të mbrojtur gratë, dhe jo vetëm ato, nga dhuna në marrëdhëniet familjare, duke rritur marzhin e dënimit të autorëve të kësaj vepre penale dhe duke zgjeruar rrethin e subjekteve të mbrojtura, ende nuk po konstatojmë ndryshimin e shumëpritur të kësaj situatë.

Ashpërsimi i sanksioneve penale nuk ka pasur gjithmonë ndikim pozitiv ose ndikimi ka qenë i papërfillshëm në arritjen e qëllimeve të legjislacionit penal, pasi nuk është shoqëruar me marrjen e masave që do të shmangnin apo parandalonin shkeljet.

Rritja e numrit të rasteve të dhunës në Shqipëri nuk duhet gjetur vetëm tek masa e dënimit, e zbutur apo e ashpër. Mbrojtja e veçantë e familjes, parashikuar në Kushtetutë nuk ka të bëjë vetëm me dënimin penal. Ligjvënësi nuk duhet të mjaftohet, vetëm duke ashpërsuar dënimin penal për subjektet e ushtrimit të dhunës në familje.

Dhuna ndaj grave mbetet një nga shkeljet më të përhapura të të drejtave të njeriut sot në botë, të cilën e gjen në çdo shoqëri e në çdo nivel ekonomik apo social. Kjo dhunë konsiderohet një shkelje sistematike dhe e përhapur e të drejtave të njeriut, që kryesisht përjetohet nga gratë për faktin se ato janë gra. Ajo shfaqet në shumë forma si dhunë fizike, emocionale, psikologjike, përdhunime e ngacmime seksuale, etj. Një dhunë e tillë shpesh konsiderohet si një formë e krimit të urrejtjes e kryer kundër grave dhe vajzave vetëm për shkak të gjinisë së tyre.

Si një nga shkaqet e rëndësishme që kanë ndikuar në mos parandalimin e këtij fenomeni, mund të përmendim, mosfunksionimin e të gjitha hallkave të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje (MKR), që duhet të ofrojnë garanci për viktimat e dhunës në familje, mosvlerësimi me përkushtimin e duhur, profesionalizëm dhe objektivitet nga strukturat e ngarkuara me ligj për identifikimin, administrimin, vlerësimin e riskut dhe referimin e rasteve të tilla në kohën e duhur në organet kompetente.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit ligjor *në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*

nga administrata publike”; si dhe nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të menjëhershme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për trajnimi në vijim dhe me prioritet i të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit, për referimin e rasteve pranë strukturave të posaçme që trajtojnë çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare, lidhur me detyrimet ligjore si autoritet përgjegjës në të gjitha strukturat vendore në varësi të saj sipas ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, me qëllim njohjen dhe zbatimin me korrektesë të detyrimeve ligjore.

2. Marrjen e masave të menjëhershme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe bashkërendim më të mirë me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të Rasteve të dhunës në familje (MKR) në bashkitë e vendit, që është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, me qëllim identifikimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, vlerësimin e riskut dhe parandalimin e ngjarjeve të rënda që sjellin humbjen e jetës së viktimave të dhunës.

3. Marrjen e masave të menjëhershme nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë për përgatitjen dhe dërgimin e një letërporosie Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallëve të Para për vlerësimin dhe hetimin e shpejtë, me objektivitet e profesionalizëm të kallëzimeve për dhunë në marrëdhëniet familjare.

4. Analizimin e këtij rasti nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nxjerrjen e përgjegjësive konkrete ligjore dhe marrjen e masave përkatëse ndaj personave përgjegjës. Po ashtu, përgjithësimin e këtij rasti me qëllim mos përsëritjen e qëndrimeve të tilla në të ardhmen.

5. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të Rasteve të dhunës në familje në Bashkinë Kamëz, duhet të rrisë bashkëpunimin me komunitetin me qëllim parandalimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare nëpërmjet identifikimit, vlerësimit, referimit, menaxhimit të këtyre rasteve dhe përcaktimit të detyrave për secilin nga anëtarët e institucioneve përgjegjëse dhe të garantimit të mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së viktimave të dhunës në familje.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merrni për zbatimin e tij, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, konform nenit 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca